



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 85, datë 26.07.2022

**PËR**

**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 37, DATË 09.05.2022, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.32, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3, RRUGA “HYSEN KERTUSHA”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr.164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, Raportit me nr. 471/41 prot., datë 15.07.2022 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetari i bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e disa shtesave në aneksin 1, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 37, datë 09.05.2022, përsa i përket listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i proçesit të rindërtimit për pallatin Nr. 32, në Njësinë Administrative nr. 3, Rruga “Hysen Kërtusha”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas tabelës si më poshtë vijon:


Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
25	ALFONS DOMI, AIDA DOMI	3	2+1
26	LINDITA BONJAKU, DENIONA NUNÇI, ERMIRA KALE	1	1+1

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 28.07.2022**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 631/prot.  
6

Durrës, më 10.08.2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
Durrës**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
Durrës**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.85 datë 26.07.2022 “Për miratimin e disa shtesave në aneksin 1, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 37 datë 09.05.2022, përsa i përket listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.32, në njësinë administrative nr.3, rruga “Hysen Kertusha”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

